



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PP/20
03.12.2020
PRISHTINE - PRISTINA



PSH.nr.888/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Rahovica Commerce” SH.P.K-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi i rrugëve me asfalt – Lot I (projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit: 656-20-6707-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Ferizaj”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rahovica Commerce” SH.P.K-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi i rrugëve me asfalt – Lot I (projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit: 656-20-6707-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Ferizaj”.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues KK-Ferizaj ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Riparimi i rrugëve me asfalt – Lot I (projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit: 656-20-6707-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Ferizaj”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Rahovica Commerce” SH.P.K-Ferizaj, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Rahovica Commerce” SH.P.K-Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me 04.11.2020 me nr. 888/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi i rrugëve me asfalt – Lot I (projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit 656-20-6707-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Ferizaj”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 69.8, 28, 44, 46, si dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe 18.3, 19.2, si dhe 18.9 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues:

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimore se është shkelur Nenit 1. Qëllimi te LPP për shkeljet e supozuara ne AK-ne këtë rast nuk qëndrojnë për piken 1 te ankesës shkeljet e -se ky nen thekson: ”Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla” AK-ne këtë aktivitet e ka respektuar LPP-ne dhe nenin konkret te theksuar nga OE Ankues. Përgjigjeje ne pretendimin ankimore se është shkelur nenin 6 i LPP-se Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Edhe këto nuk qëndrojnë sepse ky

Nen thekson "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publik edhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndë ne prokurimit".ne këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke siguruar edhe mjete qe e ka te përcaktuar ne vlerën e parashikuar për këtë aktivitet prokurimi dhe se ky projekt është tre vjeçar dhe mendoj se AK- i ka te siguruar mjetet financiare dhe po ashtu edhe ne vitet ne vazhdim i siguron mjete financiare për realizimin e këtij projekti.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor për shkeljet e Neni 7

Barazia në Trajtim /Jo-Diskriminimi. Këto pretendime nuk qëndrojnë sepse ne paragrafin 1 te këtij neni thuhet :“Autoriteti kontraktuesdo ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë tëbarabartëdhejo- diskriminuese dhedo tëveprojë nëmënyrë transparente AK,ne kete aktivitet e ka respektuar kete nen sepse aj ka shpallur proceduren prokurimi te hapur,qe eshte publikuar ne platformen e prokurimit elektronik,te gjithe ofertuesit kane qasje mund te ofertojn i kane te percaktuara kriteret transparente ,publike ,jo diskriminuese.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor per shkeljet e Neni 69.8

Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale. Lidhur me shkeljet e këtij neni te LPP-se OE Ankues ,ky pretendim është pjesërisht i bazuar edhe këtë nen te LPP-se ku ne këtë nen thuhet ne nenin 69.8 te LPP-se "Një operatore ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka meta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull ,duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve e ekonomik mundtë mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekt e të tjera. AK- ne këtë pike ne Njoftimi për kontratë dhe ne Njoftimin e mëvonshëm për Korrigjim te gabimeve ne kontratat e publikuar ka bere shkelje sepse tek Kriteret Kapaciteti teknik dhe Profesional –Lista e Mjeteve te punës nuk e ka respektuar këtë nen te ligjit sepse makineri dhe mjete te punës janë kërkuar me tepër se sa është e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate duke e pasur parasysh se kjo procedurë ka qene Riparim i rrugëve me asfalt – kontratë shërbimi ,dhe te kërkohet angazhimin i gjithë kësaj makineri dhe liste te mjeteve për kontratë te tille është e panevojshme dhe e paarsyeshme,

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor për shkeljet e nenin Neni 18.9 te RRUOPP,

Lidhur me këtë ky pretendim ku thuhet se Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve. Nuk mendoj se AK-ka ka përgatitur dosjen dhe Njoftimin për kontratë për ta favorizuar një OE,A apo për ta diskriminuar një tjetër mirëpo AK-nuk i ka përshtatur kërkuar siç duhet kriteret dhe

dëshmitë tek kriteri Kapaciteti teknik dhe profesional ,natyrës se punës ,mjeteve dhe makinerive konkrete qe nevojiten për ta realizuar këtë kontratë mirëmbajtëm tre vjeçare te rrugëve –Riparim i rrugëve me asfalt Lot. I- Projekt tre vjeçar.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor për shkeljet e Neni 19.2 te RRUOPP

Lidhur me këtë pretendim ankimor ku ky neni i RRUOPP-Thotë ;Kurdo që AK ndan aktivitetin në Lot , AK duhet të përcaktoj, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, nëse OE do të shpërblehen për: a) të gjitha Lotët; apo b) një numër të caktuar të Lotëve. Kurdo që AK përzgjedh opsionin (a), AK shpërblen OE për të gjitha Lotet ku është renditur i pari.

Kurdo që AK përzgjedh opsionin (b), AK duhet të përcaktoj në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosje të Tenderit numrin maksimal të Loteve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues. Gjithashtu AK duhet te përcaktoj në Dosje të Tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kriterëve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal. Ky pretendim i OE-se nuk te bej me këtë aktivitet prokurimi sepse ky aktivitet është ndarë ne një lot është shpallur i teri edhe se nuk ka kufizime saj përket pretendimit te OE-se ankuese se a po shpërblehet për një lot apo për te gjitha sepse këtu çka çka te ndahet – prandaj pretendimi i OE-se është i pabazë ne këtë pike te ankesës.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor lidhure me shkeljet e nenin 51.3 te LPP-se:

Njoftimi i kriterëve te përzgjedhjes, NE këtë nen thuhet :Të gjitha kriteret përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse, Ky pretendim ankimor është i bazuar sepse siç e theksuam edhe me lart ne pretendimet tjera ankimore po ashtu ne këtë nen te LPP-se thuhet se kriteret e përzgjedhjes duhet te jene relevante dhe proporcionale ne raport me lenden e kontratës përkatëse.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor lidhure me shkeljet e nenin 28 te LPP-se:

Specifikimet teknike. Ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar vetëm ne shkeljet e theksuar te paragrafit 2 te nenit te sipërcituar ku thuhet: Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Unë mendoj se kriteret e mjaftueshme për ekzekutimin e projektit ne fjale janë si ne tabelë:

	Te shpallur nga AK-ja	Sasitë e	Kriteret qe duhet ti vendos AK. ne Dosje te tenderit duhet te
--	-----------------------	-------------	--

		kërkuar	jene minimale dhe jo ashtu siç ka kërkuar AK.
1	Min. 4- Ekskavator, kapac 15-30 tone	4	Eskavator min. 15 ton
2	Min. 2 ekavator kapacit. Min. 45-48 ton	2	Eskavator min. 20 ton
3	Min. 2 eskavaor me gome 14 ton	2	Eskavator min. 10 ton
4.	Min. 1 eskavator me gome 11-12 ton	1	Eskavator me gome min. 11 ton
5.	Min 13 Kamion kapacitet 10m ³	13	Kamion kapacitet min. 10m ³
6.	Min 2 Ngarkues, 19-20 tone, kapac 1 - 2 m ³	2	Ngarkues min. 19 ton
7.	Min 2 Skip ngarkues 8 - 11t	2	Skip ngarkues min. 8 ton
8.	Min 1 Cilindër vibrues 12 t	1	Cilindër vibrues min. 10 ton
9.	Min 1 Cilindra me rrota gome gome 8 ton	1	Cilindër me rrota gome min. 8 ton
10.	Min 1 Cilindër me dhembza , vibrues 19-20 ton	1	Cilindër me dhembzor vibrues min. 15 ton
11.	Min 2 Cilindër hekur hekur min 8 ton	2	Cilindër hekur hekur
12.	Min 1 Cilindër kombinuara (gomë - hekur) 6-7T	1	Cilindër me rrota gome hekur 5-10 ton
13.	Min 1 Cilindër me rrota te kombinuara (gomë dhe hekur) 7-8T	1	Cilindër me rrota te kombinuara gome hekur min. 7 tone
14.	Min 1 Grejder min 15-17 t	1	Grejder min. 10 ton
15.	Min 1 Çekan pneumatik Hidraulik	1	Qekan pneumatik ose hidraulik
16.	Min 1 Gjysërimorkio me peshe bartëse min 54 ton	1	Gjysme rimorkio
17.	Min 1 Koke Tërheqëse	1	Koke tërheqëse
18.	Min 1 Makinë për gërryerjen e asfaltit 20-21 ton	1	Freze gërryese
19.	Min 1 Makinë për gërryerjen e asfaltit 16-18ton	1	Freze gërryese
20.	Min 2 Finisher për asfalt	2	Finisher
21.	Min 3 Kamioneta	3	Kamioneta

1			
2	Min 1 Autobote (tanket) e ujit	1	Autobode
2			
2	Min 1 Automjet special për pastrim te rrugëve	1	Automjet special për pastrim te rrugëve
3			
2	Min 2 Makine e vogël per spërkatjen e emulsionit	2	Makinë për spërkatjen emoluzionit
4			
2	Min 1 Gps per matje gjeodezike	1	GPS per matje gjeodezike
5			
2	Min 1 Kompresor ajri 22kë Min 2 Pikap per puntor	1	Kompresor ajri
6			
2	Min 1 Cistern për sperkatjen e emulzionit 9000-10000 litra	1	Cistern për sperkatje me emoluzion
7			
2	Min 2 Prerës i asfaltit	2	Prerës asfalti
8			

Lidhur me mjetet e punës mendoj se pajisjet qe nuk janë te nevojshme për ekzekutimin e kontratës te hiqen nga kriteri sipas nenit 18.9 te RRUOPP. e dosja e tenderit do te përgatitet ne meny qe nuk : 1. Kufizon konkurrencën ne mes OE-ve ose 2. Diskriminon kundër ose vepron ne favor te një ose me shume OE-ve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon paneli t shqyrtues që ankesa të pranohet si e bazuar, dhe i AK- ti korrigjon kriteret tek Kapaciteti teknik dhe profesional –lista e mjeteve te punës dhe te respekton nenin 51 te LPP-se, nenin 7 të LPP-së dhe nenin 18.9 të RRUOPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Rahovica Commere” SH.P.K-Ferizaj, me datë: 23.11.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, sqaron se AK në fazën e tenderimit ka përdorur kritere diskriminuese të cilat kritere bien në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Lidhur me kriteret e kërkuara nga AK, Paneli Shqyrtues pas shohitjes së provave vlerëson se AK ka përdorur kritere diskriminuese të cilat kritere janë kritere favorizuese për një operator, kurse diskriminuese për operatorët e tjerë. Andaj, Paneli Shqyrtues vjen në përfundim që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së, ku pajisjet që ka kërkuar AK për ekzekutimin e kësaj kontrate duhet të ndryshohen. Pra, AK për tua lehtësuar operatorëve ekonomik mundësinë e ofertimit duhet të kërkoj kritere të cilat janë të pajtueshme për të gjithë operatorët dhe mos të jenë kritere të cilat favorizohet apo diskriminohet ndonjë operator ashtu siç e precizon paragrafi 2 i nenit 7 i LPP-së: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Po ashtu, definohet edhe në RrUOPP, në piken 3. Administrimi i procedurave konkretisht 4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik., po ashtu edhe pika 4.4 Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial. Pra, AK gjatë fazës së korrigjimit apo ritenderimit të mos përdor kritere diskriminuese, por të përdor kritere të matshme të cilat kritere nuk favorizojnë apo ndalojnë operatorët ekonomik. Përveç kësaj, kriteret e kërkuara nga AK e të cilat sipas janë kritere diskriminuese dhe që duhet të vendosen për të mos u diskriminuar ndonjë operator dhe për tu favorizuar ndonjë operator tjetër, ëshë neni 18.9 i RrUOPP-së thotë se: Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

*Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose

*Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.

Andaj, AK duhet të ketë kujdes në çdo procedurë prokurimi që të mos përdor kritere të panevojshme në lidhje me natyrën e punës por të përdor kritere/pajisje të cilat lidhen me natyrën e projektit. Në lidhje me listën e pajisjeve të cilat AK ka përcaktuar kufizime të panevojshme, ato duhet ti caktoj si kufizime minimale.

Paneli shqyrtues sqaron se AK duhet të vendos kriteret në harmoni me LPP-në dhe RrUOPP-në, përkatësisht dispozitat e përshkruara si me lartë dhe mos të favorizohet apo diskriminohen OE, sepse kjo ndikon që të dëmtohet edhe buxheti i AK-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë ndryshimit dhe përmirësimit të dosjes duhet të ketë parasysh edhe nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), ku është përcaktuar se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptoj në lidhje me: (i). vlerën e parashikuar të kontratës, dhe (ii). përdorim të drejtë të fondeve publike.

Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Ferizaj”;
- 1x1 OE “Rahovica Commerce” SH.P.K,-Ferizaj;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.